

Titulli i lëndës: **Informatikë e medias**

Informatat themelore për lëndën		
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë	
Titulli i lëndës:	Zhanret e gazetarisë I	
Niveli:	Bachelor	
Statusi i lëndës:	Obligative	
Viti i studimeve:	Viti i I-rë, semestri i I-rë/ Viti akademik 2023-24	
Numri i orëve në javë:	2 + 2	
Kreditë ECTS:	8	
Koha / Vendi:	Ligjëratat: E hënë: 9-10.30 me grupin e parë; prej orës 11.00-12.30 me grupin e dytë.	
Mësimdhënësi:	Prof..Ass.Dr. Faton Ismajli, - faton.ismajli@uni-pr.edu Asistente: MA. Arbenitë Hoxha - arbenita.hoxha@uni-pr.edu	
Të dhënat kontaktuese:	E-maili për detyra: zhanre.gazetari@gmail.com	
Përshkrimi i lëndës:	Në këtë lëndë studentët studiojnë teorinë dhe praktikën për shumicën e llojeve të gazetarisë, duke filluar prej gazetarisë të tipizuar në bazë të faktorëve të ndryshëm, si medium, koha e botimit etj. Pjesa kryesore e kursit trajton zhanrin e tekstit gazetar, me përqendrim te zhanri informativ. Teoria e zhanrit përqendrohet te dy faktorë themelorë: qëllimi përmbajtjesor i tekstit dhe struktura e tekstit. Secili zhanër i ka edhe nënndarjet dhe studentët studiojnë aspektet teorike dhe praktike për secilin lloj dhe nënlloj të zhanrit gazetar.	
Qëllimet e lëndës:	Ligjërimi i kësaj lënde ka për qëllim që studentëve të vitit të parë t'u japë njohuritë bazike për ndarjet tipologjike të gazetarisë, për nocionet që lidhen me këtë fushë, për zhanret e gazetarisë, për llojet e nënllojet e tekstit gazetar; t'i aftësojë ata për të shkruar cilindo nga llojet apo nënllojet e shkrimit gazetar, për lidhjen e shkrimit gazetar me atë letrar dhe me metodologjinë shkencore të hulumtimit; t'u japë dijen e duhur dhe t'u krijojë shkathhtësinë e nevojshme për të mbledhë informacionin, për ta përpunuar atë dhe për të krijuar prej tyre formën e dëshiruar të shkrimit gazetar; t'ua bëjë të njohur ndikimin e gazetarisë, në veçanti të zhanreve të saja, në rrethe të caktuara shoqërore; po ashtu, programi	

		i kësaj lënde ka për qëllim aftësimin e studentëve në mënyrë që ata të bartin përvojat e fituara edhe te të tjerët.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:		Studenti: 1. kupton tipologjinë e gazetarisë në shumë forma, por veçanërisht tipologjinë zhanrore. Ai përvetëson nocionet themelore të zhanreve të gazetarisë. Kupton dallimet themelore midis gazetarisë informative, gazetarisë analitike dhe gazetarisë letrare (publicistikës); 2. Kupton se secili tekst gazetar ka një zhanër, i cili mund të deshifrohet nëse e zbërthejmë qëllimin përmbajtjesor të tekstit dhe strukturën e atij teksti; 3. Mbi këto dy parime studenti mësohet të dallojë zhanrin e tekstit gazetar dhe tri llojet kryesore të këtij zhanri: zhanri informativ, zhanri analitik dhe zhanri publicistik; 4. Studenti kupton dhe dallon edhe nën-ndarjet e mëtejme zhanrore: llojin dhe nënllojin zhanret; 5. Mbi këto dy parime të tekstit gazetar, studenti mëson teorikisht dhe praktikisht të shkruajë lajmin, raportin, intervistën, komentin, editorialin dhe kolumnën dhe llojet tjera gazetare. 6. Mëson lajmin dhe raportin, si shkruhen, cili është qëllimi përmbajtjesor dhe struktura tekstore ë tyre etj. Kupton llojet e ndryshme të raportit dhe dallimet në shkrimin e tyre; 7. Përfundimisht studenti aftësohet të dallojë, edhe në bazë të rregullave teorike po edhe në praktikë, secilin lloj gazetar nga tërësia e llojeve zhanrore dhe duhet të aftësohet të shkruajë secilin lloj gazetar. Ai përvetëson teknikën e shkrimit të llojeve të ndryshme gazetar, strukturën tekstore dhe përmbajtjesore të secilit lloj, gjuhën e llojit, përdorimin e burimeve të lajmit dhe të burimeve të tjera informative dhe kontekstin kur përdoret një lloj gazetar.		
		Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)		
Aktiviteti		Orë	Ditë/javë	Gjithsej

Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	20 min	15	5
Kollokfiume,seminare	20	1	20
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	15	2	30
Projektet,prezentimet ,etj	1	1	1
Totali			196 orë= 8 ECTS (196:25=7.84)

Metodat e mësimdhënies:	-ligjërata -ushtrime -test -seminar		
Metodat e vlerësimit:	Detyrat e shtëpisë: 1-20 pikë . Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 1-10 pikë Testi vlerësues – 1-20 pikë Seminari: 15 (Temat caktohen në bashkëpunim me profesorin dhe asistentin. Caktimi i temës bëhet më së largu në javën e fundit të nëntorit ndërsa dorëzimi i punimit bëhet më 20 dhjetor 2024) Provimi final: 1-35 pikë . Totali: 100 pikë . Vlerat e pikëve: 50-59 = 6/ 60-69 = 7/ 70-79 = 8/ 80-89 = 9/ 90-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese. (Nëse vërtetohet se detyrën e keni përfunduar me AI humbni mundësinë të hyni së paku një afat të provimit).		

	Provimi: 1. Detyrat e shtëpisë kryhen çdo jave dhe vlerëson me pike. 2. Vlerësimi i fundit bëhet përmes pyetjeve e përgjigjeve me shkrim që përfshinë aspektin teorik dhe praktik të lëndës.
Literatura primare:	1. Dr. Bajram Kosumi, Zhanret e gazetarisë , UBT, 2016. 2. Missouri Group, Raportimi dhe shkrimi i lajmeve, Botimet IDK, 2010 3. Stephan Rus-mohl Gazetaria, Tiranë, 2010 4. ABC e gazetarisë, Claudia Mast, 2018
Literatura shtesë:	5. Melvin Mencher, Raportimi dhe shkrimi i lajmit , Tiranë 1998 6. David Randall, Gazetari universal , ISHM, 2003.

Hartimi i planit mësimor	
Java	Ligjërata që do të zhvillohen:
<i>Java e parë:</i>	Njoftim me studentët. Njoftim me Syllabusin. Njoftim i studentëve me rolin e gazetarisë në shoqërinë moderne. Çështje të nocioneve themelore të gazetarisë dhe të zhanreve gazetare.
<i>Java e dytë:</i>	Tipologjia e gazetarisë. (fq. 23--66)
<i>Java e tretë:</i>	Lëvizje të tekstit gazetar kah zhanri. (fq. 67-85)
<i>Java e katërt:</i>	Gazetaria informative. Lajmi. Struktura tekstore e lajmit. (93-119)
<i>Java e pestë:</i>	Lajmi. Struktura tekstore e lajmit II. (119-133)
<i>Java e gjashtë:</i>	Nënloje të lajmit: Flash lajmi. Antërfajlli. Fotolajmi. Lajmi protokollar. Lajmi i titruar. Lajmi gazetaresk dhe lajmi radio-televiziv. (fq. 135-150)
<i>Java e shtatë:</i>	Raporti. (fq. 151-165) Diskutimi dhe përcaktimi i temës së seminarit.
<i>Java e tetë:</i>	Kronika. (fq. 167-172) Nekrologjia, fiçëri, përkujtimi. (fq. 173-189)
<i>Java e nëntë:</i>	Testi i I-rë (Në ushtrime përcaktohet tema e seminarit dhe dorëzohet më së largu më 20 dhjetor 2024)

<i>Java e dhjetë:</i>	Gazetaria analitike. (fq. 197-202)
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Editoriali. (fq. 202-2016)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Komenti. (fq. 217-232)
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Analiza. (fq. 251-260)
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Rishikim dhe përsëritje e kursit.
Java	Ligjërata që do të zhvillohen:

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim.